



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 18
Prishtinë, më 18 shtator 2013, në orën 10:00, salla S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Murselj Haljilji, Valbona Dibra, Imri Ahmeti, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Mungoi: Bali Muharremaj.

Të ftuar: Blerand Stavileci, ministër i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më: 10 korrik 2013, 15 korrik 2013, në orën 9:00 dhe më 15 korrik 2013, në orën 11:00;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës ;

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më: 10 korrik 2013, 15 korrik 2013, në orën 9:00 dhe më 15 korrik 2013, në orën 11:00;

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit, të mbajtura më 10 korrik 2013, 15 korrik 2013, në orën 9:00 dhe më 15 korrik 2013, në orën 11:00.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2012;

Kryetari – Opinioni i Auditimit për vitin 2012, për MBPZHR-në, është opinioni i pakualifikuar në theksim të çështjes, kjo për shkak të disa çështjeve të cilat nuk janë shpalosur mirë në pasqyrat vjetore financiare (veçanërisht shpalosja e pasurive fikse si dhe e atyre të arkëtuara), Vitin e kaluar, ZAP-i ka dhënë 8 rekomandime, nga të cilat vetëm 2 janë adresuar plotësisht, 5 janë në proces të implementimit, ndërsa 1 nga rekomandimet nuk është adresuar fare. MBPZHR-ja ka laramani të financimit si nga Grandi Qeveritar, nga të hyrat vetjake si dhe një pjesë nga donacionet, marrë në përgjithësi nga ndarja prej 26.1 milionë euro për vitin 2012, MBPZHR-ja ka shpenzuar 22.4 milionë euro apo 85.8 % e buxhetit në total. Pjesa me e madhe e buxhetit mbi 69%, ndahet dhe shpenzohet për kategorinë e Subvencioneve dhe Transfereve. MBPZHR-ja po ashtu një shumë të financimit e siguron nga të hyrat vetjake, sipas marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Financave. Shuma e mjeteve të mbledhura për vitin 2012, nga të hyrat vetjake ishte 305 mijë euro, ndërsa shpenzimi i tyre ishte deri në shumën prej 160 mijë euro.

Në kategorinë e pagave dhe mëditjeve për MBPZHR-në janë shpenzuar 1.6 milion euro apo 74.9 % e ndarjes buxhetore për këtë kategori ekonomike. Nga raporti i Auditimit janë konstatuar këto shkelje të cilat ZAP-i ka dhënë rekomandime: Angazhimi i punëtorëve me kontrata për shërbime të veçanta-përgjatë vitit 2012, janë të angazhuar 33 zyrtarë, me të cilët janë lidhur kontrata për shërbime të veçanta. Përfitues të këtyre kontratave në shumicën e rasteve janë zyrtarë administrativë të ministrisë dhe kontratat e tyre janë ripërtëri çdo muaj. Koordinim jo i plotë mes njësive organizative- Departamenti i pagesave në MBPZHR, bën pranimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve për përfituesit individual të subvencioneve sipas kriterëve të përcaktuara me Udhëzim Administrativ të ministrisë, mandej aplikacionet procedohen për pagesa. Ndërsa, subvencionimi i projekteve të OJQ-ve, menaxhohet ndaras nga Departamenti i Pagesave. Moskoordinimi brenda njësive të ministrisë, ka krijuar mundësinë që kur një rast individual të jetë i refuzuar nga Departamenti i Pagesave, i njëjti person përmes OJQ-së të përfitojë subvencionin.

Mungesa e regjistrimeve të plota- Komisioni i vendosur për inventarizim kishte bërë raportin mbi regjistrimin e pasurive dhe vlerësimin e tyre. Këtë proces e kishte përfunduar në muajin shkurt të vitit 2013. Gjatë inventarizimit, komisioni kishte cekur që një numër i mjeteve-pasurisë duhet të hidhen jashtë përdorimit ose të tjetërsohen, mirëpo, nuk kishte evidentuar se cilat janë ato pasuri.

Dy automjetet e vitit 2011, “Hunday” dhe “Toyota”, të cilat ishin dhuruar sipas marrëveshjes për dhurimin e automjeteve, nuk ishin të regjistruara në sistemin e “free balancit”. Po ashtu në sistemin E-pasuria nuk ishin regjistruar të gjitha pasuritë duke pamundësuar gjenerimin e raporteve gjithëpërfshirëse për pasuritë.

Ramiz Lladrovci, falendëroi Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për hartimin e një raporti të detajuar. Po ashtu, përshëndeti Ministrin e MBPZHR-së për angazhimin e tij në zbatimin e

rekomandimeve të dhëna nga viti i kaluar.

Murselj Haljilji - Në lëndën “Furnizimi me pleh mineral dhe foliar për nevoja të IBK” në vlerë 29,889€, kriteri i kërkuar në kontratë për origjinën e furnizimeve nuk ishte i përmbushur. OE është dashur të dorëzoi një certifikatë të origjinës së plehut mineral të cilën nuk e ka dorëzuar. Nga kjo dëmtohet fermeri, sepse humb ne kualitetin e produktit. Ministria duhet të ndërmarr diqka lidhur me standardin e kualitetit. Kontrollat e shtuara duhet të zbatohen për të siguruar që një situatë e tillë nuk mund të përsëritet dhe që kërkesat e duhura të prokurimit janë ndërmarrë në të ardhmen. Projekti i parealizuar nga OJQ –të, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit, ishte lidhur marrëveshja që të realizohet ngritje e kapaciteteve përmes shërbimeve të marketingut për prodhimet bujqësore në vlerë 7.200euro. Qëllimi ishte shpërndarja e informatave për 50 fermerë vendorë të komunave të ndryshme në Kosovë. Këto do të asistoheshin me shërbime të marketingut. Sipas marrëveshjes, organizata joqeveritare obligohet për informimin dhe koordinimin e 50 fermerëve të zgjedhur dhe të bëjë disjnimin e 300 fletushkave, 300 karta biznesi dhe hapjen e ueb faqes. OJQ-ja në këtë rast, nuk kishte kryer shërbimin plotësisht sipas kërkesave të memorandumit, pasi kishte raportuar për përzgjedhjen e vetëm 7 fermerëve, të cilët janë pajisur me ueb faqe.

Imri Ahmeti, pyeti se pse MBPZHR-ja po lejon që të ketë kontrata me punëtorët e vet për shërbime të veçanta, kur dihet se numri i punëtorëve për vitin 2013, nuk ishte i plotësuar karshi numrit të lejuar me buxhet për vitin 2012. Kjo praktikë nuk duhet të lejohet në të ardhmen. Po ashtu, ai tha se shpenzimet në kategorinë e pagave dhe mëditjeve janë shumë të ulëta.

Afrim Hoti, tha se realizimi i projekteve vetëm përmes marrëveshjes për bashkëpunim-MBPZHR, përmes marrëveshjes për bashkëpunim me operatorët ekonomikë, kishte realizuar tri projekte, 3 për afirmimin e aktiviteteve në sektorin e bujqësisë. Për këto projekte nuk janë zhvilluar procedura të prokurimit. Vlerat e projekteve nuk e kalojnë kriterin e kuotimit të çmimit. Hoti më tej pyeti se pse MBPZHR-ja nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit, kur dihet se procedurat me kuotim të çmimit nuk marrin shumë kohë. Po ashtu, çështja tjetër ishte se kishte vonesë në pagesë dhe mospërfshirje në obligime. Ministria kishte marrëveshje bashkëpunimi me KTV-në për emetim të spoteve televizive, për nevojat e MBZHR-së, në vlerë prej 5.800 euro.

Auditori ka konstatuar se raporti i pranimit të shërbimit dhe pagesa ishte realizuar në vitin 2012, ndërsa fatura i takonte vitit 2010 dhe nuk figuronte si obligim për vitin 2011. Pse nuk është paraqitur në PVF të vitit 2011 ky obligim?

Valbona Dibra, tha se Raporti i ZAP-it është mirë i detajuar. Të gjeturat e ZAP-it për MBPZHR-në nuk kanë të bëjnë me shkelje materiale. Opinioni është me theks të çështjes për shkak të regjistrimit të pasurisë, por ne si Komision, jemi dëshmitarë se kjo çështje është problematike për të gjitha institucionet dhe kjo nuk duhet të zbehë punën voluminoze të kësaj ministrie shumë vlerësuese për fermerin dhe për të gjithë ata që kanë të bëjnë me bujqësi. Duhet të merremi me këtë sfidë, por shpresoj që kjo çështje do të zgjidhet shumë shpejt. Auditori është fokusuar në pasqyrat vjetore financiare dhe në këtë rast duhet të kemi të qartë se pasqyrat vjetore financiare të kësaj ministrie janë prezantuar drejtë në të gjitha aspektet materiale, përpos regjistrimit jo të duhur të pasurisë. Kjo nuk do të thotë se nuk ka menaxhim të mirë financiar dhe të kontrollit të brendshëm. Të gjeturat duhet të trajtohen, por nuk duhet të na shqetësojnë, sepse nuk janë materiale. Inkurajoj ministrin dhe stafin për tu marrë me këto të gjetura, në mënyrë që të mos përsëriten në të ardhmen.

Alber Kinolli, pasi vlerësoi lartë punën dhe angazhimin e ministrit, kërkoi sqarim lidhur me shpenzimet tek regjistrimi i të hyrave në kode joadekuate. Në të dhënat e SIMFK-ut figuron vlera 475.948 euro, e shpenzuar për projektin Rehabilitimi i sistemit të ujitjes në Kosovë. Kjo

vlerë është regjistruar në kodin ekonomik si kapital tjetër e jo në kodin adekuat të ujitjes. Pagesat për “Ndërtimin e rrugës pyjore Keçekolla“, në vlerë 39.470 euro është bërë regjistrimi në kodin ekonomik dhe shërbimet e tjera kontraktuese, ndërsa, shpenzimi ka të bëjë me kategorinë e investimeve kapitale. Pagesat për furnizim me veshmbathje në vlerë 3.488 euro është bërë regjistrimi në kodin ekonomik dhe shërbimet e tjera kontraktuese, natyra e shpenzimit ka të bëjë me furnizim me veshmbathje.

Blerand Stavileci, ministër i MBPZHR-së – Kemi një plan të punës dhe buxhetin vjetor, por kjo nëse krahasohet me punën e kësaj ministrie, duhet bërë shumë madje ndoshta duhet ndryshuar edhe ligjet, në mënyrë që menaxhimi financiar në këtë ministri të jetë i nivelit shumë të mirë. Ne sot kemi programe disa vjeçare; 7 vjeçare - duke u munduar që ta përshtatim atë me strategjinë aktuale. Po ashtu jemi në përgatitje të strategjisë 2014 -2020, të cilën janë duke e bërë edhe shtetet e BE-së.

Që nga viti i ardhshëm, do të jemi përfitues edhe të fondeve të IPES-it, edhe pse nuk e kemi statusin e vendit kandidat. Ky program ne na paraqet probleme të ndryshme, sepse projektet është e pamundur të përfundohen me vitin kalendarik. Kjo reflekton në pasqyra financiare, por aktiviteti nuk mund të ndërpritet me përfundimin e vitit kalendarik. Është e rëndësishme se vërejtjet në këtë ministri nuk janë të natyrës materiale. Nëse flasim për një menaxhim – çështja e borxhit, krahasuar me çështjen e subvencioneve është minore, kjo jo që ajo nuk ka rëndësi, por është minore.

MBPZHR-ja përkrahet nga BB dhe tani nga DANIDA. Ne bëjmë një planifikim në dy shtylla. Me rekomandime të ekspertëve të BE -së (me qenë se ne nuk kemi një master plan në kuadër të menaxhimit të ujërave në përgjithësi) na është rekomanduar që të çështja e investimeve kapitale janë përfshirë të gjitha në këtë program. Ky program ka dy shtylla, i ndërtuar për subvencione dhe grande. Tash kemi një problem ku mund të kontribuoj edhe komisioni edhe ZAP-i, sepse Grandet sot njihen vetëm ato që jepen nga niveli qendror për atë lokal, ndërsa në anën tjetër kategorinë e Grandeve, ne e kemi futur nga viti 2010. Është praktikë të cilën e kanë instaluar vendet e BE –së me formulë të bashkëfinancimit. Por kjo te ne paraqet problem për buxhetin tonë edhe për arsye kohore edhe për arsye të kategorisë, sepse te ne ka vetëm një kategori, subvencione dhe transfere, ndërsa kjo ka mbetur ne mes të subvencioneve dhe investimeve kapitale. E njëjta vlen edhe për OJQ-të.

Ne shpallim program për fermerët. Është periudha e aplikimit, ku kanë të drejtë aplikimi të gjithë fermerët, mirëpo, çështja e promovimit, informimit nuk mund të rregullohet në këtë mënyrë. Jemi duke përgatitur një strategji lidhur me çështjen e informimit dhe komunikimit, në mënyrë që informacioni sa më shpejt të shkojë te fermerët.

Kontratat me shërbime të veçanta, është vështirë të rregullohet kjo çështje, sepse jemi në proces të riorganizimit. Në një vit e gjysmë kemi riorganizuar pjesën e Departamentit të Pagesave. Tani kemi departamentet dhe agjencitë. Riorganizimi është bërë sipas riorganizimeve që e kanë shumica e vendeve të BE-së. Me hyrjen në fuqi të ligjit për bujqësinë, ne Departamentin e Pagesave e kemi shndërruar në Agjenci. Ka pasur rrotacion të stafit, janë punësuar punëtorët dhe kemi pasur projektin e BB, që ka program për fuqizimin e autoritetit menaxhues dhe të agjencisë së pagesave, me total prej 34 punëtorëve, prej të cilëve 7 të njësisë për menaxhimin e projektit, ndërsa pjesa tjetër të agjencisë dhe te autoriteti menaxhues. Pastaj, Agjencia e pyjeve, Instituti i Bujqësisë, etj. Të gjitha këto janë në proces të riorganizimit. Punëtorët që janë me shërbime të veçanta, janë në përpunje me LSHC. Në këtë periudhë duke ditur pengesat që kemi pasur dhe jemi të interesuar që kjo të rregullohet sa më shpejt.

Mjetet që janë shpenzuar për grande dhe subvencione, janë në kuadër të asaj që është normale. Sa i përket origjinës së plehrave dhe pesticideve, më duhet t`ju informojë se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës, nuk është në kuadër të MBPZHR-së, por edhe lidhur me këtë çështje jemi duke u munduar të gjejmë një zgjidhje që kjo agjenci të jetë në kuadër të MBPZHR-së.

Sa i përket vërejtjeve të deputetëve dhe ZAP-it, edhe pse nuk janë materiale, ne na jep edhe më

shumë vullnet për t'i rregulluar dhe ministria merr përgjegjësinë për t'i adresuar saktë ato të gjetura.

Ramiz Lladrovci, lidhur me projektet të cilat nuk përfundojnë me vitin kalendarik (sepse kjo është e pamundur për shkak të specifikave në këtë ministri) ishte i mendimit që MBPZHR-ja duhet të koordinohet me ZAP-in, në mënyrë që të mos evidentohen si të gjetura.

Artan Venhar, ZAP-i punon brenda ligjeve ekzistuese dhe në kuadër të kësaj janë evidentuar të gjeturat. Jemi të vetëdijshëm, që pjesa më e madhe e buxhetit të kësaj ministrie janë subvencione dhe grande, por puna është e qëndrueshme dhe ne hapa të mirë. Sfidat janë ato me të cilat MBPZHR-ja do të ballafaqohet me integrimet evropiane.

Valbona Dibra, theksoi se MBPZHR-ja nuk është përgjegjëse për kualitetin dhe origjinën e plehrave dhe pesticideve që hyjnë dhe përdoren në Kosovë. Fakti që AUV nuk është në kuadër të kësaj Ministrie, kështu që nuk mendoj që komisioni duhet t'i drejtohet me rekomandim lidhur me këtë çështje MBPZHR-së.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me akte nënligjore të rregulloj mënyrën e komunikimit në mes të: MBPZHR, Agjencisë së Pyjeve dhe departamenteve, të cilat janë në kuadër të ministrisë, e të cilat merren me subvencione, përfshirë tani edhe komunikimin me Agjencinë për Zhvillim të Bujqësisë dhe Zhvillimin Rural.
2. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të ndërmerr hapa konkret lidhur me fuqizimin e kontrollit të origjinës së plehrave artificial, farërave, pesticideve dhe produkteve të tjera, që përdoren për nevojat e sektorit të bujqësisë në Kosovë.
3. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të bëjë një zgjidhje definitive për çështjen që ka të bëjë me angazhimin e punëtorëve me kontrata të veçanta.
4. Lidhur me rekomandimet, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me plan veprimi deri në gjysmën e dytë të muajit dhjetor, të njoftojë Komisionin për veprimet e ndërmarra dhe për mënyrën e adresimit të të gjeturave.

4. Të ndryshme

a) Kompletimi i lëndës për shqyrtim në mbledhje plenare sipas përfundimit të Kuvendit ;

Kryetari, njoftoi anëtarët e Komisionit lidhur me përfundimin e mbledhjes plenare të datës 12 shtator 2013, Nr 04-V-699, me të cilin është ngarkuar KMFP-ja për kompletimin e lëndës së RTK-së, për shqyrtim në mbledhje plenare. Sipas këtij përfundimi materialet të cilat do të procedohen për shqyrtim janë: Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, Raporti i auditimit për procesin e menaxhimit financiar dhe sistemet e kontrollit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2011, Plan aksional për aplikim e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, Letra e menaxhmentit për fundvitin 31 dhjetor 2012.

Ai, propozoi që këtij materiali t'i bashkëngjitet edhe mendimi i ZAP-it, lidhur me planin aksional të RTK-së. Kërkohej nga ZAP-i që materialin ta procedojë në mënyrë zyrtare në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri nxori këtë

Përfundim

Raportit vjetor të RTK-së për vitin 2012, për shqyrtim në mbledhje plenare t'i bashkëngjiten edhe këto materiale:

- 1. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin e Përfunduar, më 31 dhjetor 2010;*
- 2. Raporti i auditimit për procesin e menaxhimit financiar dhe sistemet e kontrollit të Radiotelevizionit të Kosovës, për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2011;*
- 3. Planin aksional për aplikimin e rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të përgjithshëm;*
- 4. Letra e menaxhmentit për fundvitin 31 dhjetor 2012 dhe*
- 5. Mendimi i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me planin aksional të RTK-së.*

b) Shqyrtimi i raporteve të auditimit të Institucioneve të pavarura, së bashku me raportet vjetore të punës.

Kryetari, ishte i mendimit që asnjë raport i punës nuk duhet të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare, pa raportin e auditimit. Drafttregullorja e re ka paraparë këtë çështje, por akoma nuk është miratuar. Në mbledhje plenare është renditur raporti i AKP-së, pa mendimin e KMFP-së lidhur me auditimin në këtë institucion.

Valbona Dibra, theksoi se është praktikë jo e mirë nëse raportet vjetore kthehen për shkak të mungesës së raporteve të auditimit të ZAP-it. Me një praktikë të tillë do të krijohet problem me agjencitë e tjera, do të vonohemi me shqyrtimin e raporteve si dhe duhet pasur parasysh faktin se një gjë e tillë nuk është e paraparë me ligj.

Ramiz Lladrovci, tha se e ka përkrahur propozimin që Raporti i RTK-së të shtyhet për shqyrtim, derisa materiali të kompletohet me raportet e auditimit. Po ashtu përkrahu propozimin që edhe raporti i AKP-së të shtyhet deri sa të shqyrtohet raporti i auditimit të AKP-së në KMFP.

Imri Ahmeti, ishte i mendimit që KMFP-ja duhet të ketë si prioritet shqyrtimin e raporteve të auditimit të institucioneve, të cilat janë të themeluara nga Kuvendi i Kosovës, e të cilat drejtpërdrejt raportojnë në Kuvend dhe në këtë mënyrë raportet do të mund të procedoheshin bashkërisht për shqyrtim. Po ashtu, Kuvendi mund të kërkojë që për ato Agjenci të cilat me ligj nuk e kanë të precizuar që t'i dorëzojnë raportet vjetore të punës bashkë me PVF- të e audituara, në momentin e dorëzimit të raportit të punës në Kuvend, t'ia bashkëngjisin edhe raportin e auditimit.

Artan Venhari - Nëse e kërkon Komisioni, ZAP-i mundet që raportet e ndjeshme të përgatitën me prioritet nga ZAP-i dhe pastaj, së bashku me raportet vjetore të punës, të diskutohen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu